



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1228

Paneli Shqyrtues, i emëruar, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga panelisti individual Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Termo Solar Engineering" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komunës së Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i nxemjeve qendrore me kaldaja me pelet në SHFMU Tre Dëshmoret në Gjurgjevik i Madh" me numër të prokurimit ;634-25-8693-5-2-1, me 203/01/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K me nr. 2025/1228, e datës 14/12/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i nxemjeve qendrore me kaldaja me pelet në SHFMU Tre Dëshmoret në Gjurgjevik i Madh” me numër të prokurimit ;634-25-8693-5-2-1. inicuar AK-Komuna Klinë.
2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, Komuna Klinë, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me te dhënat si pikën një (1) , kthehet në RIVLERËSIM.
3. Në afat prej 15 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE "Termo Solar Engineering" SH.P., i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të tarifës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.09.2025, Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i nxemjeve qendrore me kaldaja me pelet në SHFMU Tre Dëshmoret në Gjurgjevik i Madh” me numër të prokurimit 634-25-8693-5-2-1.

Me 26.11.2025 datën ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues njoftimin për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë “Lurn SHPK”.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, ndërsa lloji i kontratës është kontratë për punë, me vlerë të parashikuar të kontratës prej 16,000.00 €.

Me datën 30.11.2025, OE “Termo Solar Engineering” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK, e cila është refuzuar me datën 04.12.2025.

Me datën: 14.12.2025, OE “Termo Solar Engineering” SH.P.K, ka parashtruar ankesë me nr. 2025/1228 i pakënaqur me vendimin e AK-së.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesave, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 173/24 dhe ankesa nr. 180/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE “Termo Solar Engineering” SH.P.K

Gjate fazës se rivlerësimit kemi kërkuar dëshmi mbi pronësinë e platformës ngritëse me gërshëre sipas kërkesës se DT, por ne dokumentet e dorëzuara në fazën e sqarimeve ju keni dorëzuar dëshmi dhe marrëveshje për platforme te cilën e keni bashkangjitur ne ofertën tuaj.

Shiko Listen :

TERMO SOLAR ENGINEERING SH.P.K.

LISTA E PAISJEVE						
Titulli i projektit: "Ndërtimi i nxemjeve qendrore me kaldaja me pelet në SHFMU Tre Deshmoret në Gjurgjevik i Madh"						
Numri i prokurimit: 634-25-8693-S-2-1						
Nr.	LLOJI I MAKINËS	MARKA DHE TIPI	LLORI MOTORIT	VITI I PRODHIMIT	NR.SHASHISE	PESHA
5	Platform ngritese		Dizel	1999		8 Bar
6	Platform ngritese gershere	iteco/ iG10130W5	Dizel	2000		2920
7	Furgon me 4 dyer	volkswagen/	Dizel			01-286-JV
8	Trapan Bosch GRH 5-40 DCE	BOSCH				
9	Sherre Bosch GSA 18 V-LI	BOSCH				
10	Ratifikuese Bosch GWS 180-LI(C) solo	BOSCH				
11	Setvegltash per mekanik 186pjes krom					
12	Prerese gypt CT-432 r132mm					
13	Dana knipex ALIATOR 002009 V03 Set					
14	Trapan GRH 240					
15	PIKAP	volkswagen/caddy	Dizel	2005	WV2222K26X001813	2260 KG
						04 - 615 - G1

Shiko deshmin :



Proforma Invoice

Metal Mont Shpk
NUI:810254053
Komoran 13050 Kosovo Rr.Skender
Mulaku nr.328

Tel: +383 44 170 730

Stehouwer International BV
De Maalstroem 11
8255 RN Swifterbant

Telefoon +31 (0)321 322506

IBAN NL42RAB00152742829
BIC/Swift RABONL2U

KVK 62955103
BTW NL855027782801

Date: 21-5-2025
Number: prf 250521001

Discription	Netto (€)
Liftlux SL125-22LD4WDS 4x4 diesel scissor lift platfform s/n: 3104239 Year of manufacture: 2003 Weight: 8230 KG HS-code: 84281080	3.500,00

Exportdocuments

70,00

Pretendimet ankimore të OE “Termo Solar Engineering” SH.P.K në ankesën Nr. 2025/1228

Pretendimi ankimor: Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues, me Njoftimin për Vendim të datës 26.11.2025 (B58), ka ndryshuar në mënyrë të pajustificuar vendimin paraprak të datës 30.10.2025, me të cilin ankuesi ishte rekomanduar për kontratë, duke e eliminuar nga procedura e prokurimit dhe duke rekomanduar për kontratë një operator tjetër ekonomik me çmim më të lartë se oferta e ankuesit.

Sipas ankuesit, në Letrën Standarde Autoriteti Kontraktues ka paraqitur vetëm një arsye për eliminim, përkatësisht se ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi mbi pronësinë e platformës së deklaruar në Listën e Pajisjeve. Ankuesi vlerëson se ky arsyetim është i pabazuar dhe nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit/Fletës së të Dhënave të Tenderit.

Ankuesi sqaron se DT/FDT ka kërkuar si kapacitet teknik një (1) platformë ngritëse gërshërë dhe një (1) furgon kombi, ndërsa si dëshmi ka paraparë dorëzimin e Listës së Pajisjeve të nënshkruar dhe të vulosur, të mbështetur me faturë, librezë regjistrimi ose DUD doganor, ose në rast të marrjes me qira/shfrytëzim, me marrëveshje të nënshkruar dhe të vulosur.

Në përputhje me këto kërkesa, ankuesi pretendon se ka dorëzuar dokumentin “1.14 Lista e Pajisjeve – TSI”, në të cilin janë deklaruar dy (2) platforma ngritëse gërshërë. Për këto pajisje, sipas ankuesit, janë dorëzuar faturat e blerjes, si dhe marrëveshjet për shfrytëzim me operatorët ekonomikë që i posedojnë këto platforma, duke qenë se pajisjet janë në përdorim.

Ankuesi më tej pretendon se, pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues për sqarim të tenderit të datës 19.11.2025, ka dorëzuar sërish Listën e Pajisjeve dhe dëshmitë përkatëse për platformat e deklaruara, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur me ofertë, duke dëshmuar disponueshmërinë e dy (2) platformave, ndonëse kërkesa minimale ka qenë për vetëm një (1).

Sipas ankuesit, Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar këto dëshmi në mënyrë të plotë dhe nuk ka sqaruar se cilat dokumente konkrete mungojnë, duke refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa dhënë përgjigje të arsyetuar. Ankuesi vlerëson se kjo mënyrë e veprimit është në kundërshtim me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të trajtojë dhe vlerësojë sqarimet dhe dëshmitë e paraqitura.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/12/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1228.

Lidhur me pretendimet e OE “Termo Solar Engineering” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1228 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigja e ekspertës shqyrtuese: Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin ankimor lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues dhe ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të palëve në platformën e e-prokurimit, përfshirë dokumentacionin e publikuar nga Autoriteti Kontraktues (AK).

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit, Fletës së të Dhënave të Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë rezultojnë se AK ka kërkuar, në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional, si “Makinë dhe mjete pune të disponueshme”, një (1) platformë ngritëse gërrshëre dhe një (1) furgon kombi. Si dëshmi është përcaktuar dorëzimi i Listës së mjeteve të punës, e nënshkruar dhe e vulosur, e mbështetur me dokumente përkatëse (faturë, librezë regjistrimi, DUD doganor), ndërsa në rast të marrjes me qira/shfrytëzim, dorëzimi i marrëveshjes së nënshkruar dhe të vulosur.

Konkretisht, në FDT është përcaktuar si vijon:

“Makinë dhe mjetet e punës të disponueshme:

- Një (1) platformë ngritëse gërrshëre;
- Një (1) furgon kombi.

Përcjellë me dëshmi dokumentare:

Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik duhet të ofrojë listën e mjeteve të punës të nënshkruar dhe të vulosur në origjinal, të dëshmuar me fatura ose librezë të regjistrimit valide, faturë për blerje, DUD doganor në emër të kompanisë me të cilën konkurron ose grupit të operatorëve ekonomikë që konkurrojnë, ose mund të merren me qira për këtë projekt, me marrëveshje të nënshkruar dhe të vulosur.”

Në këtë pikë, eksperti vëren se, ndonëse FDT parashikon mundësinë që pajisjet të merren me qira/shfrytëzim, kërkesa mbi dëshminë dokumentare për këtë rast nuk është e strukturuar dhe e përcaktuar qartë. Formulimi i FDT-së i rendit në një fjali të vetme disa lloje dokumentesh që lidhen me pronësinë në emër të ofertuesit (fatura, librezë regjistrimi, DUD doganor), dhe më pas shton “ose mund të merren me qira... marrëveshja e nënshkruar dhe e vulosur”, pa sqaruar në mënyrë të prerë nëse, në rast të qirasë/shfrytëzimit, kërkohet vetëm marrëveshja apo marrëveshja së bashku me dokumente të pronësisë së pajisjes në emër të palës dhënëse. Për pasojë, ky formulim krijon hapësirë për interpretime të ndryshme gjatë fazës së vlerësimit.

Sa i përket arsyes së eliminimit, nga dokumentacioni rezultojnë se AK e ka bazuar vendimin në konstatimin se OE ankues nuk ka paraqitur dëshmi mbi pronësinë e platformës së deklaruar në Listën e Pajisjeve.

Nga Lista e Pajisjeve e dorëzuar me ofertë, eksperti ka vërejtur se OE ankues ka deklaruar dy (2) platforma ngritëse gërrshëre, konkretisht në pozitat nr. 5 dhe nr. 6 të Listës së mjeteve të punës / Listës së pajisjeve. Si dokumentacion shoqërues për disponueshmërinë e pajisjeve, është bashkëngjitur marrëveshja për dhënie në shfrytëzim (qira) me OE “MULTI SOLUTIONS SH.P.K.”, e lidhur në emër të projektit konkret të prokurimit. Duke iu referuar kërkesës së FDT/Njoftimit për Kontratë, sipas së cilës “në rast marrjeje me qira/shfrytëzim kërkohet marrëveshje e nënshkruar dhe e vulosur”, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur.

Megjithatë, eksperti vëren se AK ka kërkuar sqarime shtesë për tenderin me datë 19.11.2025, duke bashkëngjitur në këtë kërkesë edhe Listën e Pajisjeve të dorëzuar nga OE ankues. Duke marrë parasysh natyrën e dokumentacionit të dorëzuar fillimisht dhe paqartësitë e mundshme që rrjedhin nga formulimi i kërkesës në DT/FDT për rastet e marrjes me qira/shfrytëzim, dokumentacioni plotësues i paraqitur nga OE ankues në fazën e sqarimit do të duhej të trajtohej si pjesë e procesit të verifikimit të përmbushjes së kërkesës.

Në këtë kuadër, OE ankues ka paraqitur dy (2) marrëveshje të reja për dhënie në shfrytëzim (qira) të platformave të deklaruara, të shoqëruara me dy (2) fatura përkatëse në emër të projektit.

Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues vlerëson se, edhe në rast se Autoriteti Kontraktues ka synuar të interpretojë kërkesën e DT/FDT-së në një formë më restriktive lidhur me dëshminë e disponueshmërisë së pajisjeve, një interpretim i tillë do të duhej të bëhej në raport me Listën e Pajisjeve të dorëzuar me ofertë, në të cilën OE ankues ka deklaruar dy (2) platforma ngritëse gërrshërë. Për rrjedhojë, dokumentacioni shtesë i paraqitur pas kërkesës për sqarim do të duhej të trajtohej si qartësim dhe plotësim i dëshmive për pajisjet tashmë të deklaruara, dhe, si i tillë, të konsiderohej i pranueshëm në kuadër të verifikimit të ofertës.

Mbështetur në analizën e mësipërme, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor rezulton i bazuar, në kuptim të përmbushjes së kërkesave të DT/FDT-së dhe mënyrës së trajtimit të dokumentacionit nga Autoriteti Kontraktues.

Përfundimi

Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së prokurimit, pretendimeve ankimore dhe analizës së mësipërme, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e ngritura nga OE ankues gjejnë mbështetje dhe rezultojnë të bazuara.

Nga shqyrtimi rezulton se AK nuk ka siguruar që vlerësimi i ofertave është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 59.4 të LPP-së, si dhe me dispozitat për ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve sipas nenit 40 të RrPP-së.

Po ashtu, duke pasur parasysh se OE ankues (GOE) ka dorëzuar ofertën me çmimin më të ulët, ndërkohë që kontrata është rekomanduar për një operator ekonomik me ofertë më të lartë, rezulton se çështjet e ngritura prekin edhe parimet e përdorimit efikas të fondeve publike, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë, të përcaktuara në nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që AK të kryejë një vlerësim të plotë, të arsyetuar dhe në përputhje me kërkesat e DT/FDT-së dhe dispozitat e LPP-së dhe RrPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE deklaron se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin

kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të dhënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes Dosjes së tenderit/Njoftimit për kontratë, ku Raporti me rekomandim i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K, janë të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i nxemjeve qendrore me kaldaja me pelet në SHFMU Tre Dëshmoret në Gjurgjevik i Madh” me numër të prokurimit; 634-25-8693-5-2-1. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues e mbështet raportin e ekspertit, në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “ELSAM” SHPK janë të bazuara.

Paneli shqyrtues duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i nxemjeve qendrore me kaldaja me pelet në SHFMU Tre Dëshmoret në Gjurgjevik i Madh” me numër të prokurimit; 634-25-8693-5-2-1, ka vendosur të Anullohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, i datës, 26.11.2025 dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në

Rivlerësim. Obligohet AK /Komuna Klinë, që në procesin e rivlerësimit të zbatojnë konstatimit/vlerësimet të pretendimeve ankimore, si pjesërisht të bazuara dhe si të bazuara të ankuesit, OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K sipas raportit ekspertit shqyrtues, të cilat Paneli shqyrtues i mbështet dhe konform nenit 40.2.1 të Rregullores nr.002/2024 Prokurimit Publik, vetëm sa i përket korrigjimit të parregullsive ligjore sipas këtij vendimi.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/1228, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit si të bazuar të ankesës të OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - Termo Solar Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: